

# SHËNDETI *i Kryeqytetit*



PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA

PRISHTINA


PRISHTINA

PRISHTINA

DREJTORIA E SHËNDETËSISË • PRISHTINË

REVISTË  
PËR SHËNDETËSI

NUMËR JUBILAR  
QERSHOR • 2024



*Gëzuar Prishtinë!*



## PËRMBAJTJA

- 3** Prof. Ass. Dr. Izet Sadiku, PhD, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë - Prishtinë ● EDITORIAL  
25 vjetori i shëndetësisë në kryeqytet;
- 6** Dr. Bujar Gashi, MA, Specialist i mjekësisë familjar: Vizitat sistematike të fëmijëve në shkolla;
- 9** Prof. Ass. Dr. Isuf Bajrami, PhD, Specialist i mjekësisë urgjente &  
Dr. Avdyll Pacolli, MSc., Specialist e mjekësisë familjare;
- 13** Dr. Nazane Breca, MSc., Specialiste e mjekësisë familjare: Fillet e mjekësisë familjare në Kryeqytet;
- 16** Dr. Violeta Haxhiaj Nobrdali, MSc., Specialiste e mjekësisë familjare:  
Klimi në kohë me intervistën me Dr. Bajram Tahirin;
- 19** Dr. Sahadete Kelmendi, Specialiste e mjekësisë familjare: Shërbimi i mjekimit shtëpiak dhe historiat e tij;--
- 23** Dr. Xhevrije Canolli, Specialiste e mjekësisë familjare & Dr. Nexhmedin Hoti, Specialist i Epidemiologjisë:  
Zhvillimi i njësive të vaksinimit në periudhën e pas luftës në komunën e Prishtinës;
- 27** Znj. Merita Kongjeli Bajraktari, BSc: Infermiera shkencë dhe art
- 31** Znj. Donikë Novosella, BSc, Infermiere: Përjetimet e një infermiereje;
- 33** Dr. Ramë Sadikaj, Internist: Shërbimi specialistik në kuadër të QKMF në Prishtinë;
- 35** Gjyljije Sherifi, BSc. Mrs, Infermiere: Pediatria në kryeqytet- njësi e dashurisë dhe përkujdesjes së fëmijëve;
- 38** Dr. Erzen Begolli, Gjinekolog: Qendra për mirëqenien e gruas dhe shërbimet që ofron;
- 40** Znj. Xhevahire Shala, Infermiere: Copëza të kujtimit tim, mbi përkushtimin dhe sakrificën time në ofrimin e kujdesit shëndetësor;
- 42** Znj. Bukurije Bunjaku, Infermiere: Roli dhe rëndësia e DSM në menaxhimin e TB në Kryeqytet;
- 44** Znj. Fikrie Ademi, Infermiere, BSc.: Roli dhe rëndësia e infermierisë kryeqytetase;
- 47** Prof. Ass. Dr. Valdet Hashani, MD, MSc, PhD, Specialist i mjekësisë familjare:  
Disa informacione për mjekësinë familjare;

## 51 INFO

### REDAKSIA

*Kryeredaktor:* Dr. Rushit Ismaili

*Anëtarë:* Dr. Izet Sadiku, Dr. Bujar Gashi, Dr. Rrezart Halili,

Dr. Valdet Hashani, Dr. Vjollca Zeqiri, Dr. Violeta Haxhiaj - Nobrdali,

Dr. Shpresa Krasniqi, Dr. Besim Murseli, Dr. Florina Grezda, Dr. Besarta

Azizi, Dr. Aida Jusufi, Znj. Merita Bajraktari - Kongjeli, Znj. Teuta

Mehmeti, Znj. Ema Gashi, Znj. Arbnora Sahiti & Znj. Argjentina Deliu.

*Design, Kopertina & Faqosja:* Dr. ValDetH. '24



Prof. Ass. Dr. Izet Sadiku, PhD, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë-Prishtinë.

# 25 VJETORI I SHËNDETËSISË NË KRYEQYTET

**K**anë kaluar 25 vite kur edhe shëndetësia sikur edhe vet Kosova kanë filluar një fazë të re të zhvillimit të tyre. Edhe sistemi shëndetsëor para 25 viteve ishte i shkatërruar nga lufta dhe tani po fillonte periudha e krijimit të institucioneve shëndetësore në një Kosovë të lire dhe demokratike.

Shëndetësia ka qene e shkatërruar si pasoje e një periudhe 10 vjeçare të largimit të mjekëve dhe puntorëve shëndetsëor nga vendet e punës nga ana e pushtetit të Serbisë, ku si në shumë fusha tjera edhe në shëndetësi kanë punuar dhe verpruar vetëm institucionet e dhunshme të Serbisë.

Gjatë kësaj periudhe sikur edhe në fushat tjera ka filluar krijimi i institucioneve të pavaruar shëndetësore e duhet përmendur shërbimit shëndetësor të Shoqatës Humanitare Bëmirëse “Nëna Terezë” e cila ka ofroar rreth 4 milion shërbime dhe vizita mjekësore me mijëra punëtorë shëndetësor dhe të gjitha shërbimet mjeksore përfshi barnat të cilat janë ofruar pa pagesë, gjatë gjithë periudhës 1992-1999.

Para 25 viteve ka filluar edhe krijimi dhe funksionalizimi i instituconeve shëndetsëore dhe tani Prishtina ka:

- Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare me 34 institucione shëndetsëore,
- Qendërne Mjekësisë Urgjente me 5 punkte të saj dhe
- Poliklinikën Stomatologjike si institucionin e parë të mjekësisë sekondare në kryeqytet.
- Vetëm vitin e kaluar janë ofruar mbi 3.500.000 shërbime mjekësore dhe mbi 1.100.000 vizita shëndetsëore.
- Tani kemi forcuar shërbimi shtëpiak i cili jep mbi 200 vizita dhe shërbime gjatë 365 ditëve të vitit duke ofruar shërbime 12 orë në ditë për të gjithë ata pacientë të cilët për shkak të moshës ose sëmundjes nuk mund të marrin shërbime në qendrat e mjekësisë familjare.
- Bëhen analizat laboratorike të rreth 30 parametrave laboratorike, kemi fillur realizimin e analizave të hormoneve të gjëndrrës tiroide dhe HbA1c të cilat bëhen cdo ditë të javë në tri qendra në kryeqytet,
- Vaksinimi bëhet në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, e cila ka ndikuar që qytetarët të rrisin shkallën e vaksinimit.
- Për herë të parë janë trajnuar 12 mjekë familjar në Prishinë dhe kanë filluar realizimin e ultrazërit të abdomenit gjatë realizimit të vizitave të pacientit nga mjeku familjar.
- Kemi rritur shërbimet radiologjike me theks shërbimet e mamografisë dhe tani kemi me tre mamograf, në të cilët vitin e kaluar janë ofruar mbi 3000 mamografi.
- Kemi renovuar shumicën e ambulancave dhe qendrave të mjekësisë familjare të cilat janë pajisur me aparaturë dhe teknologji të re mjekësore.



**QENDRAT E  
MJEKËSISË  
FAMILJARE  
PO RENOVOHEN  
NË TËRSI**

- Tani jemi në fazën e fundit që mbas 25 viteve të shëndetsësisë në kryeqytet të filloj ndërtim i Spitalit të Prishtinës i cili ka qenë projekt i domosdoshën që nga paslufta në kryeqytet.
- Duhet përmendur rolin e madhë që ka luajtur shërbimi shëndetsëor në kryeqytet në ballafaqim me njërin nga prombelmet me të mëdha të shëndetit publik me pandemin COVID19.
- Shërbimi shëndetsëor ka qenë shembull si si duhet punuar dhe vepruar në periudha të vështira kur duhet dhënë shërbime për të gjithë qytetarët edhe pse kapacitetet dhe mundësit kanë qenë të kufizuara, por me anagzhimin e të gjithë stafit, ky shërbim ka arritur që qytetarët të ndihen të sigurt dhe të marrin shërbimet e nevojshme.

Njëra nga sfidat e shëndetësisë është numri i vogël i stafit në kujdesin parësor shëndetësor si dhe formimi i institucioneve sekondare shëndetësore në shëndetësi bazuar në ligjin për kryeqytetin, me qëllim të krimit të shërbimeve bashkohore dhe cilësore për qytetarë.

Në këtë jubile përveq përveç që po bëjmë një restrospektiv të zhvillimit të shëndetësisë , të arriturave sfidave jemi anagzhuar që të nderojmë dhe vlersojmë të gjithë që kanë kontribuar në zhvillimin e shëndetësisë në kryeqyte në kohërat më të vëshitira të saj.

Dhe kur përmendim këtë periudhë të gjithë neve që e bajmë mend nuk mundemi pa e përkujtu edhe një here punën e shërbimit shëndetësor të SHHB "Nëna Terezë" e nisur në një lagje të kryeqytetit në lagjen e Kodrës së Trimave e cila ishte një shpresë për të gjithë ata qytetarë të cilët kishin mbetur pa shërbime shëndetësore.

Kjo ambulance e filluar në Kodrën e Trimave shumë shpejt i shpërndau shërbimet në gjithë Kosovën dhe numronte mbi 100 ambulanca mjekësore në Kosovë.

Dhe më meritori për këtë punë gjigante në kohë okupimi padyshim ishte njeriu i qetë, fjalë pakë, shumë i përpikt dhe vizionar i cili angazhoi me mijëra puntorë shëndetësor e ky ishte humanisti Dr Gano Demolli.



Tani në shenjë vlerësimit dhe nderimit të punës dhe veprës së Dr. Gani Demollit ne kemi vendosur që Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në kryeqytet të emrohet Dr. Gani Demolli.

Me këtë veprim ne po nderojmë veprën dhe punën e atyre mijërave mjekëve , infermeirëve, punëtorëve teknikëve, shoferëve, pronarëve të cilët lëshuan shtëpitë etyre gratis dhe mundësuan formimin dhe zhvillimin e sistemit siq njëhej atëherë paralel të shëndetësisë të Republikës së Kosovës.

**Urime 25 vjetori i shëndetësisë së kryeqytetit!**



Dr. Bujar Gashi, MA, Specialist i mjekësisë familjare

## VIZITAT SISTEMATIKE TË FËMIJEVE NË SHKOLLA


Vizitat sistematike të fëmijëve shkollorë janë një nga masat parandaluese të cilat Kujdesi Parësor Shëndetësor i bën me vite. Nëpërmjet këtyre vizitave synohet që të mbikqyret gjendja shëndetësore e nxënësve. Mendohet se nxënësit e shkollave janë popullatë e re dhe e shëndetshme; prapë se prapë, QKMF e Prishtinës dëshiron të sigurohet që shëndeti i tyre është i përmbushur në aspektin e zhvillimit psiko-fizik. Me raste, zbulohen çrregullime që janë të veçanta për grupmoshat përkatëse. Ideja është që zbulimi të jetë sa më i hershëm, në mënyrë që heret të merren masa përmirësuese: masa parandaluese, shëruese dhe rehabilituese.

Vizitat sistematike janë organizimi i Drejtorisë Komunale për Shëndetësi në Kryeqytet në bashkëpunim me Drejtorinë e QKMF-së dhe bëhet për nxënësit e Shkollave Fillore të Mesme të Ulëta të klasëve të para, të pesta dhe të nënta.

## Çfarë shikohet në këto vizita?

Me këto vizita vlerësohet zhvillimi i përgjithshëm psiko-fizik i fëmijëve, përfshirë shëndeti oral. Parametrat që vlerësohen janë:

- Matja e peshës trupore dhe gjatësisë (vlerësim standard sipas diagramit);
- Kontrolli i të pamurit sipas tabelës (Snellen);
- Të dëgjuarit;
- Kontrolli detal klinik i lëkurës, kokës, hundës, gojës, dhëmbëve, gjëndrës tiroide, zemra, mushkëritë, abdomeni, ekstremitetet, boshti kurrizor, krahëror;
- Zhvillimi psiko-motorik, pjekuria sociale dhe emotive.



## Kush i kryen këto vizita?

Për realizimin e vizitave sistematike janë formuar 15 ekipe, të cilat fillimisht njoftohen për metodologjinë dhe procedurat vlerësuese. Secili ekip përbeht nga:

- Një mjek familjar;
- Dy infermiere të mjekësisë familjare;
- Një doktor i stomatologjisë;
- Një asistent i stomatologjisë.

## Çfarë nxirret nga këto vizita?

Gjatë vizitave sistematike hetohen probleme nga më të ndryshme të cilave pastaj përpiqet që t'u bëhet zgjidhje. Në raste të identifikimit të fëmijëve me ushqyeshmëri të dobët, këshillohet që t'u ofrohet mbështje familjare dhe institucionale për mënyrën e drejtë të ushqyerjes. Te rastet e fëmijëve me mbipeshë, ofrohet edukim shëndetësor për mënyrën e jetesës, si: marrja me aktivitet fizik, promovimi i të ushqyerit të shëndetshëm, shamngia e ushqimeve me shumë kripë, sheqer dhe yndyrë.

Me raste, identifikohet edhe fëmijë me probleme të pamurit, referohen te okulisti për mundësinë e pajisjet me syza me dioptri. Brengë mbetet problemet me shtyllën kurrizore, të cilat po identifikohen më shumë kohëve të fundit, kjo për arsye të ndryshme, si: mbajtja jo e drejtë e trupit, përdorimi i tepërt i telefonëve të mençuar (smartphone, ipad, etj.), pesha e rëndë e çantës. Rekomandohet që prindët dhe mësimmhënësit të kujdesen që fëmijët/nxënësit t'i shmangin këto probleme. Në raste të deformimeve të rënda, nxënësit referohen të specialistët e lëmive përkatëse.

Një problem tjetër jo i rrallë është higjiena e gojës dhe kariesi i dhëmbëve. Për këtë rekomandohet larja e rregulltë e dhëmbëve me furçë dhe fluorizimi i pastave të dhëmbëve dhe shtimi i fluorit në ujë.



Mjekët e QKMF së Kryeqytetit shfrytëzojnë çdo mundësi që të flasin me prindët dhe me fëmijët për të gjitha këto gjera. Përveç kësaj, kohëve të fundit është duke u nxjerrë Revista "Shëndeti i Kryeqytetit", e cila shërben për edukimin dhe promovim shëndetësor të popullatës së Kryeqytetit, përfshirë edhe edukimin për rritjen dhe zhvillimin e duhur të nxënësve.

Vizitat sistematike përsërite çdo katër vite, ashtu që nxënësit e klasës së pare do të vizitohen përsëri në klasën e pestë dhe të nëntë.

Vizitat sistematike shërbejnë për të nxjerrë informacionin e duhur, në mënyrë që pastaj të bëhen politika të duhura që adresojnë këto probleme dhe të bëhet edukimi në drejtimin e kërkuar.





Prof. Ass. Dr. Isuf Bajrami, PhD,  
Specialist i mjekësisë urgjente



Dr. Avdyl Pacolli, MSc.,  
Specialist e mjekësisë familjare

# SHËRBIMET E QENDRËS SË MJEKËSISË URGJENTE TË KRYEQYTETIT

Lëmia i emergjencës mjekësore është një fushë relativisht e re në mjekësinë e Kosovës.

Për ngritjen e një sistemi shëndetësor të shkatërruar ndihmë të madhe dhanë ndërkombëtarët.

Ata me përvojën dhe donacionet e tyre, bazuar në resurset humane ekzistuese, ngritën një shërbim të ri – sistemin e mjekësisë emergjente.

Në maj të vitit 2001, themelohet Enti i Ndhmës së Shpejtë Mjekësore (ENSHM), ndërsa puna në objekt të ri, i cili u ndërtua nga mjetet vetanake të Kuvendit Komunal të Prishtinës, filloi në maj 2004. Në vitin 2011 ENSHM ndrron emertimin në Qender të Mjekësisë Urgjente (QMU).

Qendra e Mjekësisë Urgjente është institucion shëndetësor i cili ofron gjatë 24 orëve:

Ndihmë urgjente mjekësore të sëmurëve rëndë dhe personave të lënduar, në qytetin e Prishtinës (sipas nevojës edhe në periferi në fshatrat që gravitojnë në Komunën e Prishtinës) në rrugët magjistrale, në vendndodhje dhe gjatë transportit.

- Bën transportin e të sëmurëve me gjendje të rënduar shëndetsore, të lënduarve, pacientëve të palëvizshëm deri tek institucionet shëndetsore në regjionin e qytetit ose jashë shtetit në përciellje të mjekut, infermierit, varësisht nga gjendja e pacientit ose kërkesës së mjekut përgjegjës.
- Me kërkesë të organizatorit ofron kujdesin shëndetësor në manifestime kulturo-sportive ose dhe në tubime e shfaqjeve të ndryshme ku marrin pjesë numër i madh njerëzve.
- Ofron dërgimin e një autoambulance të gjithë atyre që kanë nevojë për ndihmë urgjente.
- Organizon dhe zbaton mësimin teorik dhe praktik nga Mjekësia Urgjente për të gjithë pjestarët e shërbimeve mjekësore në urgjencë dhe pjestarët tjerë të interesuar të institucioneve shëndetsore.
- Është institucion që ndihmon shërbimet urgjente në qendrat që gravitojnë në regjionin e Prishtinës, siç janë: Fushë Kosova, Obiliqi, Podujeva, Drenasi, Lipjani, Graçanica dhe Shtimja.
- Njëkohsisht QMU kujdeset dhe ju përgjigjet thirrjeve të gjithë qytetarëve pa dallim etnie, si dhe ju del në ndihmë stafit diplomatik ndërkombëtar që jeton dhe vepron në Prishtinë.

Paraprakisht personeli shëndetësor i QMU-së mbajnë ngrije profesionale nëpërmjet të kurseve të trajnimit. Janë dy kurse të rëndësishme që u ndihmojnë atyre të ballafaqohen me punën në terren. E para që duhet të dihet është reanimimi kardiopulmonar (masazha e zerrës dhe dhënia e frymëmarrjes artificiale) dhe defibrilimi që bëhet nëpërmjet aparaturës së veçantë, e cila shërben për rikthimin e punës së zerrës. Këto dy procedura janë të dobishme për ta mbajtur pacientin në jetë, deri në momentin e dërgimit në spital.



REANIMIMI KARDIOPULMONAR, VEPRIM BAZIK NË SHPËTIMIN E JETËS TE ARRESTI KARDIAK

## Autoambulancat

Autoambulancat janë pjesë e rëndësishme e punës së QMU. Janë disa ekipe që kur marrin informacionin nga dispečeri (personi që i pranon thirrjet telefonike të qytetarëve në nevojë urgjente), i cili pastaj njofton ekipin e lirë që të shkojë në vendin e caktuar ku edhe jepet ndihma e kërkuar. Ajo që vlen të theksohet se viteve të fundit është punuar shumë që të zvogëlohet koha e pritjes.



HAPSIRA E BRENDSHEM TË AUUTOAMBULANCES SË QMU-SË ME PAISJE STANDARDE KU TRAJTOHET PACIENTI

Për të gjithë qytetarët e kryeqytetit me rrethinë si dhe rrugët magjistrale, kemi numrin unik **194** ku mund të kontaktoni pa pagesë për çdo urgjencë mjekësore.



**CALL  
194**

*është numër falas (pa pagesë), aktiv 24 orë në 7 ditët e javës*

## Kur të telefononi

- Në të gjitha situatat kur mund të ketë rrezik për jetën ose lëndime të rënda fizike, si në rastin e sëmundjeve të menjëhershme, traumave, helmimeve, djegieve, mbytjeve, aksidenteve (në ambientet e shtëpisë, rrugë, bujqësi, industri, në punë etj).

### **Si të telefononi 194**

- Formoni nr. 194
- Përgjigjuni me qetësi pyetjeve të bëra nga operatorët dispiçer
- Jepni një nr. kontakti
- Jepni arsyen e thirrjes telefonike (sëmundje, aksident, fatkeqësi, helmim etj)
- Jepni adresën e plotë ku ndodhet i sëmuri (qytet, fshat, rrugë, kryqëzim, pallat, institucion dhe çdo pikë e njohur pran jush)
- Jepni numrin e përsoneve të përfshirë
- Përshkruani gjendjen e pacientit: përgjigjet, merr frymë, a ka gjakderdhje etj.
- Përshkruani situatat e veçanta: fëmijë i vogël, grua shtatëzënë, persona me sëmundje të njohura si: sëmundje të zemrës, astma, diabeti, epilepsi
- Biseda zhvillohet me zë të qartë dhe duhet të jepen përgjigjet sa më të plota në mënyrë që dispiçeri të arrij analizimin e plotë të situates
- Kujdesuni që nr. i kontaktit të jetë i disponueshëm për të krijuar mundësinë e komunikimit në çdo kohë me ekipin e urgjencës.

Në pritje të shërbimit të urgjencës

### **Çfarë duhet të bëni?**

- Siguro vetën
- Lironi me kujdes rrobat e ngushta (rrip, kravatë, etj) për të lehtësuar frymëmarrjen
- Mbuloni pacientin kur temperaturat janë të ulta
- Jepni siguri dhe inkurajoni pacientin
- Në rast aksidenti, mos pengoni ardhjen e ekipit mjekësor dhe sinjalizoni kalimtarët për rrezikun
- Telefononi sërish **194** nëse gjendja e pacientit përkeqësohet

### **Çfarë nuk duhet të bëni?**

- Mos u friksoni
- Ruani gjakftohtësinë
- Mos lëvizni të lënduarin
- Mos i jepni ushqim ose pije
- Mos i jepni ilaçe pa u konsultuar me mjekun
- Kur nuk duhet telefonuar **194**
- Për shërbimet jo-urgjente si: vizitat e planifikuara, daljet nga spitali, transferimet ndër-spitalore
- Për trajtim mjekësor të specializuar
- Për informacione me natyrë social-shëndetësore si: orari i shërbimeve, planifikim vizitash shëndetësore, ekzaminimet ose testet diagnostike.

### **Na kontaktoni**

Ju mund të na kontaktoni në çfarëdo mënyre të dëshironi.

Jemi të gatshëm të ju përgjigjemi në çdo kohë.

**Shpëtimi i jetës së pacientit është moto e punës sonë!**

Adresa e QMU-së, Rruga Fehmi Lladrovci, Nr.8, PRISHTINË



Dr. Nazane Breca, MSc, Specialiste e mjekësisë familjare

# FILLET E MJEKËSISË FAMILJARE NË KRYEQYTET

Pas përfundimit të luftës, në muajin qershor të 1999, një pjesë e madhe e popullatës u kthyen në Kosovë nga vendet ku ishim strehuar, pas dëbimit të dhunshëm nga okupatori serb. Edhe unë me familjen time u këthyem nga fundi i qershorit nga Kroacia, aty ku ishim strehuar. Pas thirrjes publike që të gjithë të kthehemi në vendet tona të punës, në Korrik u lajmërova tek drejtori i “Shtëpisë së Shëndetit”, Dr. Bajram Tahiri, për të filluar punën. Dy javët e para kam punuar në terene të ndryshme, sipas nevojës, ndërsa pastaj u emërova shefe e “Stacionit të IV” shëndetësor (tani QMF IV) në “Xhemajl Ibishi”.

Gjatë fillimit të punës, sikurse në shumicën e institucioneve shëndetësore, u ballafaquam me sfida të ndryshme, duke filluar nga shkatërrimi apo dëmtimi të objekteve shëndetësore, me mungesë të terapisë për pacientë, mungesë të pajisjeve, me një fluks shumë të rritur të pacientëve, etj. Por entuziazmi që ishim këthyer në vendin tonë dhe dëshira e madhe për të ndihmuar pacientët i tejkaloi të gjitha sfidat.

Në fillim të Vitit 2000, nga Organizata Botërore e Shëndetësisë(OBSH), u përzgjedhën 10 mjekë nga mbarë Kosova, që të fillojnë specializimin e Mjekësisë Familjare në Univerzitetin e Utrecht-it në Holandë, nën udhëheqjen e një organizate ndërkombëtare joprotabile, CORDAID. Pesë nga këta mjekë ishin të Prishtinës. Krahas një kursi shumë intensiv në specializim, përfunduar edhe një kurs shumë intensiv për aftësimin si trajnerë të Mjekësisë Familjare, me ç'rast edhe fituan titullin Trajner të Mjekësisë Familjare.



## STAFI SHËNDETËSOR QMF IV - 1999

Pas disa muaj pune dhe angazhimi shumë të madh, u këthyem në Kosovë dhe vazhduam programin e specializimit, nën udhëheqjen e “Kolegjit Mbretëror të Mjekëve Familjar” të Mbretërisë së Bashkuar, e krahas kësaj edhe trajnimin e trajnerëve. Në këtë mënyrë u rritë numri i trajnerëve të Mjekësisë Familjare. Menjëherë pas kësaj në kuadër të Shtëpisë së Shëndetit (tani Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-QKMF), u themelua “Qendra e Trajnimit të Mjekësisë Familjare”(QTMF). Me 2002 diplomuan gjenerata e parë e Mjekëve Familjarë dhe shumë shpejt filloi implementimi i konceptit të Mjekësisë Familjare, koncept bashkëkohor që u ofron popullatës shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse, kualitative dhe mirret me:

- Diagnostifikimi dhe menaxhimi i sëmundjeve akute dhe kronike, trajtimi i emergjencave, shërbimet shëndetësore në shtëpi.
- Prevenimi i sëmundjeve.
- Monitorimi dhe vazhdueshmëria e përkujdesjes për sëmundjet rekurente kronike.
- Rehabilitimi pas sëmundjes.
- Shërbimet antenatale dhe postnatale, këshillat mbi kontracetim dhe dhënia e tyre.
- Shërbimi paliativ.
- Koordinimi i shërbimeve për të rrezikuarit, përfshirë fëmijët, të sëmurit mental, të moshuarit, rastet me nevoja të veçanta dhe ata që kujdesen për të sëmurit e lartpërmendur.
- Ofrimi i ndihmës për pacientët dhe të afërmit e tyre që në mënyrë adekuate të identifikojnë institucionet për përkujdesje dhe përkrahje përfshirë këtu specialistët e spitalit.
- Udhëzimin tek specialisti nëse është e domosdoshme (kthimi prapa i pacientit të MF)
- Shërbime shëndetësore për fëmijë
- Imunizimin (vaksinimin)
- Promovimin / edukimin shëndetësor në komunitet
- Trajtimin e lëndimeve të vogla - Kirurgjia e vogël

- Vizita shtëpiake
- Identifikimin e grupeve vulnerable dhe të rrezikuara
- Dhënien e barnave nga lista esenciale
- Shërbime 24-orëshe të Urgjencës dhe QKMF/QMF

Kështu me fillimin e implementimit të konceptit të mjekësisë familjare, Shtëpia e Shëndetit u shëndrrua në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), ndërsa Stacionet shëndetësore u shënrruan në Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF).



## DONACIONET E PAS LUFTËS ISHIN SHPRESË E MADHE PËR PACIENTËT TANË

Në kuadër të QTMF-së u themelua njësi e “Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional të Mjekësisë Familjare”(ZHVP), ku mjekët familjarë në mënyrë të vazhdueshme informohen me metoda dhe terapitë më të reja të trajtimit të sëmundjeve të ndryshme.

Gjithashtu në kuadër të QTMF u themelua edhe njësi e “Kontrollit të Cilësisë”, ku në mënyrë të vazhdueshme kontrollohet cilësia e shërbimeve shëndetësore që u ofrohen pacientëve dhe aty ku vërehen vështërsitë apo mangësitë, ndërmerren hapat konkrete për përmirësimin e tyre.

Sot në kryeqytet ekzistojnë shumë QMF, që ofrojnë shërbime kualitative shëndetësore popullatës. Synohet që në cdo 10000 banorë të ketë një QMF që do të ofrojë shërbime (të jetë sa më afër popullatës). Secili individ dhe familja e tij kanë të drejtë që ta përzgjedhin mjekun e vet familjarë në mënyrë që do të ekzistoj një vazhdimsi në përcjelljen e pacientit dhe familjes, të mirret me parandalimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve të ndryshme, duke marrë parasysh gjithmonë edhe faktorin social dhe atë psikologjik.

Synohet që vizitat të jenë me termine (që të mos ketë pritje të kota dhe humbje të kohës), të ketë listim të pacientëve (që individ dhe familja e tij të kontrollohen tek i njejt mjek familjarë i cili më së miri e njih historinë e sëmundjes apo ndonjë problem tjetër, rrethanat sociale, psikologjike etj.) dhe në këtë mënyrë do ta menaxhojë pacientin më lehtë dhe më mirë.



Dr. Violeta Haxhij Nobrdali, MSc, Specialiste e mjekësisë familjare

## KTHIMI NË KOHË, INTERVISTË ME DR. BAJRAM TAHIRIN

Kishim nderi dhe knaqësin që të takonim Dr. Bajram Tahirin që na ktheu në kohë me rrefimin tij plot emocion e krenari për kthimin në punë të punëtorëve shëndetësor me 21 qeshor të vitit 1999, pasi që ishin larguar nga pushteti i atëherëshëm.

Rrefim plot emocion si është bërë thirrja e punëtorëve shëndetësor nga RTVSH nga gazetarja Besa Çeku nga lajmet e mbrëmjes të orës 20:00.

### **Kthimi ne kohë ne vitet prej 1990 deri me 1999.**

Dr. Bajram Tahiri në 1990 ishte drejtor i “Shtëpisë së Shëndetit” që sot është QKMF, në gusht po atë vit e kishin larguar nga puna. Vullneti e dëshira për punë ishte e madhe, që qytetarëve të ju ndihmohet, menduan si të ofrojnë shërbime shëndetësore. Këto shërbime shëndetsore kanë qenë një formë e vetëorganizimit për ofrimin e tyre. Që nga viti 1990 ishin themeluar një sërë klinika private ose ambulance humanitare.



### Duhet të përmendën disa karakteristika të veçanta të tyre:

- Punëtorët shëndetësorë punonin pa kompensime materiale.
- Të gjitha ambulancat ishin vendosur në shtëpi private dhe të ofruara nga populli pa kompenzim material.
- Dyert e këtyre ambulancave ishin të hapura për të gjithë qytetarët.
- Të gjitha shërbimet shëndetësore, barnat dhe materialet sanitare ishin falas.



- Paisjet mjekësore, barnat, materialet sanitare furnizoheshin nga shumë organizata, asociacione dhe individ nga mbarë bota.

### Periudha 1999

Pasi kishte shkruar që punëtorët të kthëhen në punë, e lajmin e kishin dëgjuar nga lajmet nga RTVSH, punëtorët shëndetësor me plot entuziazem e të mbushur më emocione ju përgjigjen thirrjes së drejtorit Dr. Bajram Tahirit.

U rikthye në detyrën që kishte qenë në vitin 1990, drejtor. Pas kthimit në zyren e tij janë bërë përpjekje për renovimin e qendres, mjete si barna, shiringa, gjilpera e material tjera kishte gjetur të paketuar për tu larguar nga “ Shtëpia e

Shëndetit” të gjitha i kishte rikthyer ne vendin e tyre, kishte rikthyer ne vendin e tyre edhe autoambulancat dhe mjete stomatologjike, rrefim plot emocion nga dr. Bajrami.

Sistemimin e punëtorëve e kishte bërë sipas lokalizimit, ku punëtorët shëndetësor kanë dashur të kontribuojnë më afër vendit. Ishin rreth 500 punëtorë shëndetësorë. Kanë pasur edhe donacione për zhvillim e mjekësisë dhe për furnizimi me barna dhe materiale shpenzuese. Një ndër meritat me të mëdha që i atribuohen Dr. Bajram Tahirit, përveç shumë të tjerash, ishte edhe mudësia që iu dha mjekëve që të ngriten profesionalisht.



Pas luftës se vitit 1999 Kryeqyteti ka bërë përmisime të mëdha në KPSH. Gjatë kësaj periudhe për shërbime shëndetësorë kanë marrë disa donacione dhe mbështetje financiare ndërkombëtare, janë ndërtuar dhe renovuar objekte , numri i stafit është zgjeruar, është rritur numëri i shërbimeve mjekësore dhe vizitave çdo ditë e më shumë.



Dr.Sahadete Kelmendi, Specialiste e Mjekësisë Familjare

# SHËRBIMI I MJEKIMIT SHTËPIAK DHE HISTORIATI I TIJ

Shërbimi i Mjekimit Shtëpiak-Prishtinë apo si njihej,,Shërbimi Kronik” u themelua në vitin 1986 si njësi e veçantë në kuadër të QKMF-së (Shtëpisë së Shëndetit siç quhej atëherë).

Kontribues për hapjen e Shërbimit të Mjekimit Shtëpiak ka qenë dr.Avni Idrizi tani më i ndjerë.Shërbimi ka funksionuar rregullisht deri në vitin 1992 kur me dhunë largohen puntorët Shqiptarë nga vendet e punës nga regjimi i atëhershëm,me çrast dhe ky shërbim pushon se ekzistuari.Pas luftës rihapet deri në vitin 2003,ku dhe pati një nderprerje sa i përket funksionimit te tij.Ndërkaq nga dhjetori i vitit 2005 e tutje Shërbimi ka vazhduar punën pandërprerë edhe përkundër sfidave dhe vështirësive të mëdha që ka pasur

## Funksionimi & sfidat e Shërbimit Shtëpiak

Deri në Qershorin e vitit 2020-të Shërbimi ka funksionuar me orar pune nga ora 7-15-h me një staf te vogël (dy mjekte dhe katër infermiere). Në Qershorin e 2020-ës (në kohën e pandemisë COVID-19) shërbimi zgjerohet me staf të ri ( dy mjekë dhe tre infermiere me kontrat mbi vepër) Orari i punës për Shërbimin nga tani ndryshon dhe fillon të punohet me dy ndërrime, dy ekipe në ndërrim të paradites 07-13.h dhe dy ekipe nga ora 13-19.h nga dita e hënë -premtë ( pesë ditë/javë)

Nga dt.1 mars 2022 Shërbimi punon shtatë ditë/ javë, përfshirë fundjavat dhe festat nga ora 07-19.h. Ndërkaq me përfundimin e kontratës (mbi vepër) për dy mjekte dhe tre infermiere në Qershor të vitit 2023, Shërbimi has në vështirësi të mëdha si mungesë e stafit, dhe më shumë pas ndarjes nga jeta të dr. Azijada Jaminit që ishte një humbje e madhe për të gjithë .

Plot një vit Shërbimi ka funksionuar me një mjekte të rregullt dhe tre mjekë mbështetës (çdo ditë) Andaj gjej rastin të falëndëroj Menaxhmentin e QKMF-së Shefat e Njësisë dhe kolegët për mbështetjen e ndihmën e pakursyer që i kanë dhënë Shërbimit dhe pacientëve tanë. Nga dt.1-Qershor 2023 Shërbimi kompletohet me staf (4 mjek dhe një infermiere) ndërsa me konkursin e fundit këtë vit ishte kërkesë që të përfordhem me tre infermierë dhe një mjekte (pasi nje mjekte iku ne specializim ne tetor te vitit te kaluar)

Nga 1 janari 2023 Shërbimi Shtëpiak është njësi e veçantë në kuadër të QKMF-së ka dhe Menaxherët e vet, Shefe dhe Infermierën përgjegjëse

Unë jam pjesë e Shërbimit që nga viti 2008, e nga 1 janar 2023 mbaj dhe pozitën e UD. Shefe në këtë njësi. Pa kaluar modestinë them që me gjithë vullnetin, dijen, angazhimin dhe kapacitetin tim, kam bërë të pamundurën në mbarëvajtjen e Shërbimit, që të jetë këtu ku është e që gëzon respektin e merituar nga të gjithë si nga pacientët dhe kolegët tanë

Asnjëherë nuk guxon të anashkalohet kontributi i secilit që ka kaluar nga dyert e Shërbimit Shtëpiak, atyre që janë në mesin tonë dhe atyre që nuk janë. Respekt pafund për Dr. Azijada Jamini, Inf, Shqipe Lumi që paten fatin e keq të ikin nga kjo botë, si dhe infermierën Naxhrije Berisha e cila arriti të pensionet këtë vit.



➡ NË VITIN 2024 STAFI I SHËRBIMIT PËRBEHET NGA:  
PESË MJEKË, NËNTË INFERMIER, DHE KATËR VOZITËS.

## Përfituesit e këtij Shërbimi

Janë pacientët me sëmundje të rënda, ata që për arsye të ndryshme shëndetësore nuk mund të vizitojnë as Qendrën më të afërt mjekësore, qofshin ata me sëmundje kronike, malinje, të retarduar, pas Insulteve cerebrovaskulare, pacientët me shputa diabetike, amputime të gjymtyrëve të poshtme, pacientët pas aksidenteve apo pas intervenimeve kirurgjike etj.

Mbi këtë parim bazë mbështetet Shërbimi e që është paaftësia e pacientit për lëvizje..

Është Shërbimi ynë që ju rrinë afër qytetarëve me gjendje të rëndë shëndetësore si dhe ekonomike, dhe këta janë më perfituesit më të mëdhenjë sa i përket marrjes së shërbimeve mjekësore. QKMF-re Menaxhmentet e kaluara si dhe ai i tanishëm janë kujdesur në mënyrë të veçantë, dhe i kanë dhënë gjithmonë prioritet Shërbimit Shtëpiak sa i përket furnizimit me terapi, material shpenzues, pajisje mjekësore, uniforma për stafin deri te sigurimi i veturave të reja- Autoambulancë (vitin e kaluar) gjithmonë duke marrë në konsideratë natyrën e punës së Shërbimit-në terren si dhe kategorinë e pacientëve që e trajton.



AUTOAMBULANCA E SHËRBIMIT SHTËPIAK

## Shërbimet mjekësore për pacientët

Me shumë se 200 vizita dhe shërbime mjekësore ofrohen çdo ditë për këta pacientë, qofshin vizita aplikim i therapisë, glicemi, Oksigjenoterapi, matje e parametrave vitalë, ekzaminimet tjera shtesë, kateterizime, lidhje & pastrim dhe fashim plage, etj. Krahasuar me tre vitet e kaluara i bie që kemi rritje për 300% të shërbimeve mjekësore për

pacientët. Hapësirë dhe vend më të rëndësishëm gjatë vizitës mjekësore zënë: edukimi dhe këshillimi për pacientët dhe familjarët e tyre,,qofshin këto për përcjelljen dhe monitirimin e parametrave vitalë,marrjen e rregullt të therapisë,dietën,higjenën,aktivitetin fizik aq sa ka mundësi të bëhet nga këta pacientë,jepen këshilla në aspektin psikologjik që është shumë i nevojshëm tek këta pacientë,sidomos për pacientët dhe familjarët e tyre në stadin e fundit të jetës.

-Shërbimi Mjekimit Shtëpiak është shërbim shumë delikat dhe i ndjeshëm për personat që kanë mundësi të kufizuar për marrjen e ndihmës mjekësore,andaj stafi ynë është shumë i përkushtuar për të dhënë më të mirën dhe të mundurën me qëllim t'ju ndihmojë kësaj kategorie por duhet dhe angazhim dhe mirëkuptim dhe nga strukturat Qeveritare dhe kompetente që të bëhet dhe më shumë për këtë kategori

Dhe në fund ajo që kisha dashur të ju them pacientëve tanë : Ne jemi këtu për ju,dhe do jemi me ju deri në fund të jetës,të ju përkrahim në aspektin mjekësor,psikologjik dhe shpirtëror aq sa kemi,dije, mundësi dhe kapacitete.



NJË PJESË E STAFIT TË SHËRBIMIT SHTËPIAK



Dr. Xhevrije Canolli, Specialiste e mjekësisë familjare

# ZHVILLIMI I NJËSISË SË VAKSINIMIT NË PERIUDHËN E PAS LUFTËS NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Njësia e vaksinimit në periudhën e pasluftës ka funksionuar me pesë Qendra, ndërsa stafi shëndetësor, shumica e të cilëve edhe sot e kësaj dite punojnë në këtë njësi, kanë filluar punën në muajin shtator të vitit 1999 ku udhëheqës i kësaj njësie u emërua epidemiologu dr. Nexhmedin Hoti.

Pas analizimit të situatës lidhur me imunizimin e popullatës dhe raportimit nga qendrat e vaksinimit u konstatua se shkalla e përfshirjes me vaksinim primar ishte vetëm 28%, një rrezik për ndonjë epidemi eventuale. Me këtë gjendje njësitë e vaksinimit filluan punën në Komunën e Prishtinës, ku pas planifikimit dhe riorganizimit të njësisë së vaksinimit

fillon vaksinimi sipas kalendarit të rregullt të imunizimit. Në këtë kohë zhvillohet imunizimi kontinuel brenda njësive si dhe imunizimi me ekipe mobile në teren, përfshi fshatrat dhe shkollat e Komunës së Prishtinës

Me qëllim të mbulueshmërisë sa më të shpejtë të popullatës me imunizim, në vitin 2000 formohen katër ekipe mobile me të cilat përfshihen edhe Komuna e Obiliqit dhe e Fushë Kosovës. Në disa fshatra ekipet janë transportuar nga forcat e KFOR-it për çështje sigurie si dhe nga Mjekët e Botës (Medicins du Monde) për shkak të mungesës së mjeteve transportuese që ishin sfidat më të mëdha për realizimin e procesit të vaksinimit në teren asokohe. Një nga sfidat kryesore ishte edhe furnizimi me vakcina, ruajtja e zingjirit të ftohtë duke pasë parasysh mungesën e pajisjeve adekuate si dhe mungesën e rrymës elektrike në periudhën e pasluftës.

Në fund të vitit 2000 me qëllim të parandalimit të përhapjes së Paralizës së fëmijëve/ Polyomielitit u organizua fushata kundër kësaj sëmundje. Si rezultat i një pune intenzive të profesionistëve shëndetësor shkalla e përfshirjes me vaksinim primar rezultoj me ngritje nga 28% në 80% brenda një viti.

Në vitin 2001/2002 për njësinë e vaksinimit u siguruan katër mjete transportuese si dhe u angazhuan pesë vozitës që krijuan kushte më të mira për imunizimin e popullatës në vendet më të largëta të Komunës së Prishtinës. Imunizimi kampanjë në fshatra organizohej gjashtë herë brenda një viti kalendarik. Imunizimi realizohej me informim paraprak nga tre zyrtar të cilët shpërndanin ftesat dhe mobilizonin popullatën.

Në tetor të viti 2003 u organizua edhe fushata kundër Fruthit e cila u realizua me sukses duke mos regjistruar asnjë rast të fruthit nga viti 2000 deri në vitin 2017.

Pas realizimit të suksesshëm të fushatave të lartëcekura, njësia e vaksinimit vazhdoj me planifikim dhe riorganizim për ofrimin e shërbimit të vaksinimit sa më afër qytetarëve dhe tani imunizimi reaizohet në gjashtëmbëdhjetë Qendra të Mjekësisë Familjare në Komunën e Prishtinës.

Njësia e vaksinimit në vazhdimësi organizoj trajnime dhe ligjerata profesionale me punonjësit shëndetësor nga të gjitha Qendrat e vaksinimit si dhe mori pjesë në përgatitjen e materialit informues edukativ për fletëpalosje që u shpërnda në të gjitha Qendrat Familjare në shërbim të qytetarëve. Poashtu u organizuan ligjërata edukativo-shëndetësore në shkollat e Komunës së Prishtinës përfshirë edhe ligjeratat për Komunitet me qëllim të vetëdijësimit për rolin dhe rëndësinë e imunizimit.



VAKSINIMI ËSHTË JETIK



Sfida e radhës ishte rritja e numrit të rasteve me Fruth në tetor të vitit 2017 që falë mobilizimit të shpejtë të ekipeve mobile në teren ( shkolla, çerdhe, shtëpia private etj) u arrit që brenda tre muajve të frenohet përhapja e epidemisë së Fruthit që konsiderohet si një ndër sukseset më të mëdha të profesionistëve shëndetësor . Gjatë periudhës kohore 2018-2019 shkalla e mbulueshmërisë arrin në 97% ku vendi ynë ishte një prej vendeve më të suksesshme në rajon sa i përket imunizimit

Në mars të vitit 2020 pasi u regjistruan rastet e para me Covid 19, me rekomandim të IKSHPK-së u ndërpre vaksinimi i rregullt i fëmijëve deri në muajin Maj kur edhe rifillon vaksinimi i rregullt i fëmijëve në QKMF ndërsa në Qendrat tjera ku shërbimi i vaksinimit nuk ishte i ndarë nga shërbimet tjera, për të evituar kontaktin direkt me personat eventualisht të infektuar me Covid 19, vaksinimi u realizua në tenda pranë Qendrave familjare me mbështetjen e IKSHPK-së dhe UNICEF-it

Pandemia Covid- 19, ballafaqimi me këtë sëmundje dhe pasojat që la pas, tregoj edhe njëherë se sa i rëndësishëm është vaksinimi. Me datë 29 Mars 2021 filloj procesi i vaksinimit kundër Covid-19 sipas Planit Shtetëror të Imunizimit në Qendrën sportive” 1 Tetori” në Prishtinë. Nga kjo datë e deri me datë 20 Dhjetor 2021 procesi i vaksinimit kundër Covid-19 ka qenë nën mbikqyrjen dhe menaxhimin e Komisionit për menaxhim dhe mbikqyrje të procesit teknik të vaksinimit kundër Covid-19 në nivel vendi, anëtarë të këtij Komisionit nga QKMF- Prishtinë ishin Dr. Xhevrije Canolli në cilësinë e menaxhimit dhe sistemimit të ekipeve mjekësore dhe infermierja Florie Rashani në cilësinë e përcjelljes së zingjirit të ftoftë, furnizimit dhe distribuimit të vaksinave kundër Covid-19



Synimi kryesor i fushatës antiCovid- 19, ishte vaksinimi sa më i shpejtë i një pjese të madhe të popullatës (të paktën 70%) që do të frenonte përhapjen e infeksionit SARS-Cov2 dhe do të ndërprente pandeminë aktuale.

Një prej sfidave kryesore të kësaj periudhe ishte furnizimi me vakcina, numri i vogël i ekipeve mjekësore që në fillim ishin vetëm tre ekipe nga qendra e vaksinimit, që ndërkohë u mbështetën dhe u ndihmuan nga ekipet e Qendrave tjera familjare të Komunës së Prishtinës, ekipet e komunave tjera si dhe ekipet nga specialistët dhe infermierët e kontraktuar nga MSH.

Numri i ekipeve mjekësore arriti në 50 ekipe me ndihmën e të cilave në muajin shtator të këtij viti realizuam me sukses “Imunizimin në masë” të qytetarëve ku numri i të vaksinuarve brenda ditës ishte rreth 5000.

Me 20 dhjetor 2021 bëhet zhvendosja e ekipeve të vaksinimit nga salla “1 Tetori” në institucionet e KPSH-së në QMF VII edhe për gjishtë muajt e rradhës. Përkundër të gjitha sfidave procesi i vaksinimit kundër Covid-19 nga një fillim i vonshëm dhe i pashpresë u bë storje suksesi, e gjithë kjo falë punës së palodhshme të profesionistëve shëndetësor, përkushtimit Institucional , mbështjetjes nga Organizatat kredibile, vendore dhe ndërkombëtare si dhe përgjigjes pozitive të qytetarëve në këtë fushatë.

Pandemia Covid-19 sikurse edhe në vendet tjera ka ndikuar në shkallën e imunizimit dhe shëndetin publik. Megjithatë objektivi kryesor i njesisë së vaksinimit mbetet arritja dhe ruajtja e shkallës së lartë të mbulueshmërisë me vaksinim të rregullt.

## VAKSINIMI SHPËTON JETË...VAKSINOHU!



Merita Bajraktari Kongjeli, BSc., Infermiere

# INFERMIERIA SHKENCË DHE ART

## Një Kombinim i Shkencës dhe Artit

Infermiera është një profesion i rëndësishëm që ndërthur shkencën dhe artin, këtu do të shqyrtoj se si infermiera përmban elemente të këtyre dy fushave.

### **Infermiera si Shkencë**

Infermiera është një shkencë sepse përdor njohuri shkencore.

Infermierët bazohen në dijeni të thella për procesin shëndetësor të njeriut dhe përdorin metodat e hulumtimit dhe praktikën e bazuar në dëshmi.

Përdorimi i teknologjisë dhe praktika e bazuar në dëshmi bëjnë që infermiera të jetë një shkencë.

### **Infermiera si Art**

Infermiera është gjithashtu një art.

Përveç njohurive teknike, infermierët duhet të kenë aftësi të ndjekin intuitë dhe të jenë kreativë në mënyrën e trajtimit dhe qasjes ndaj pacientit.

Arti i infermierisë përfshin empatinë, komunikimin dhe aftësinë për të krijuar një lidhje të fortë me pacientët.

### **Kombinimi i Shkencës dhe Artit**

Infermiera është një kombinim i shkencës dhe artit.

Përdorimi i njohurive shkencore për të ofruar kujdesin e duhur ndaj pacientëve është një sfidë e vërtetë.

Infermierët duhet të jenë të aftë të përdorin teknikat e hulumtimit dhe të jenë një burim i kujdesit dhe përkrahjes për pacientët.

Në fund, infermiera është një profesion i rëndësishëm që kombinon shkencën dhe artin për të siguruar kujdesin më të mirë për pacientët.

### **Ndërveprimi emocional midis Infermierit dhe pacientit**

Ndërveprimi emocional midis infermierit dhe pacientit është thelbësor për ofrimin e kujdesit cilësor dhe ndihmën e duhur për pacientët. Në këtë drejtim, ka disa strategji që mund të ndihmojnë në rritjen e ndërveprimit emocional:

#### **Empatia dhe mirëkuptimi**

Infermierët tregojnë empati ndaj pacientëve. Kuptimi dhe ndjeshmëria ndaj ndjenjave të tyre ndihmon në krijimin e një lidhjeje të fortë emocionale.

Dëgjimi aktiv dhe vëmendja ndaj nevojave të pacientit janë thelbësore.

#### **Komunikimi efektiv**

Infermierët janë të aftë të komunikojnë hapur dhe pa prirje. Komunikimi i qartë dhe i kujdesshëm ndihmon në kuptimin e nevojave të pacientit.

Përdorimi i gjuhës së thjeshtë dhe të qartë ndihmon në rritjen e ndërveprimit emocional.



## INFERMIERIA ËSHTË SHKENCË & ART

### **Krijimi i besimit**

Infermierët punojnë me sinqeritet për të fituar besimin e pacientit. Siguria dhe ndjenja e besimit ndihmojnë në ndërveprimin emocional.

Tregimi i sinqeritetit dhe ndjeshmëria ndaj ndjenjave të pacientit ndihmojnë në krijimin e një mjedis të besueshëm.

### **Ndjekja e nevojave individuale**

Çdo pacient ka nevoja të ndryshme. Infermierët duhet të jenë të aftë të identifikojnë dhe të përgjigjen ndaj nevojave të secilit pacient.

Përqëndrimi në individë dhe respektimi i ndryshimeve të tyre ndihmon në rritjen e ndërveprimit emocional.

### **Kujdesi personal**

Infermierët duhet të tregojnë kujdes personal ndaj pacientëve. Një buzëqeshje, një fjalë inkurajuese, ose një ndjenjë e vëmendjes ndaj pacientit ndihmon në ndërveprimin emocional.

### **Kujdesi dhe vëmendja ndaj detajeve të vogla janë të rëndësishme.**

Në përfundim, ndërveprimi emocional ndihmon në përmirësimin e kujdesit shëndetësor dhe ndihmën për pacientët. Infermierët duhet të jenë të ndjeshëm dhe të përqendrohen në krijimin e një lidhjeje të fortë me pacientët.

### **Roli i Infermierisë në sigurinë dhe kujdesin e pacientit**

Infermiera është një profesion shëndetësor i përqendruar në kujdesin e individëve, familjeve dhe komuniteteve në mënyrë që ata mund të arrijnë, të mbajnë/ ruajnë, ose të shërojnë shëndetin optimal dhe cilësinë e jetës . Ky profesion kombinon artin dhe shkencën, duke kërkuar një kombinim të shkathtësive teknike dhe cilësive humane.

Infermierët përfundojnë edukim, trajnime të vazhdueshme dhe arsim të specializuar si BSc, MSc etj. Këto programe ofrojnë njohuri të thella në vlerësimin e pacientëve, administrimin e ilaçeve, kujdesin ndaj sëmundjeve, plagëve dhe komunikimin me pacientët.

Infermierët janë kujdestarët e parë. Ata administrojnë ilaçe, monitorojnë shenjat vitale dhe ofrojnë mbështetje emocionale për pacientët dhe familjet e tyre.

Ata bashkëpunojnë me mjekë, terapistë dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë për të krijuar plane kujdesi të plotë.

Infermierët ndihmojnë në promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve. Ata edukojnë pacientët rreth stilit të jetës të shëndetshëm, ushqimit dhe menaxhimit të problemeve kronike të pacientët.



**INFIERMIERET LUAJNË NJË ROL TË MADH NË PROMOVIMIN E SHËNDETIT & NDIHMËN PËR PACIENTËT NË MENAXHIMIN E SËMUNDJEVE KRONIKE.**

### **Roli i Infermierisë në kujdesin Primar të Shëndetit**

Infermieria është një profesion i rëndësishëm në kujdesin primar të shëndetit. Këta profesionistë luajnë një rol të thellë në promovimin e shëndetit dhe ndihmën për pacientët në menaxhimin e sëmundjeve kronike.

#### **Kujdesi drejtpërdrejt ndaj pacientëve:**

Infermierët janë kujdestarët e parë. Ata administrojnë ilaçe, monitorojnë shenjat vitale dhe ofrojnë mbështetje emocionale për pacientët dhe familjet e tyre.

Bashkëpunojnë me mjekë, terapistë dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë për të krijuar plane kujdesi të personalizuar.

#### **Edukimi për shëndetin:**

Infermierët ndihmojnë në promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve. Ata edukojnë pacientët rreth stilit të jetës të shëndetshëm, ushqimit dhe menaxhimit të kushteve kronike.

Infermierët e komunitetit organizojnë ngjarje shëndetësore, kryejnë skanimet dhe rrisin ndërgjegjësimin për çështje shëndetësore publike.

#### **Avokacia**

Avokacia është një aspekt themelor i infermierisë. Infermierët mbrojnë të drejtat e pacientëve dhe sigurojnë që ata të marrin kujdes cilësor.

Ata ngrisin zë kur siguria e pacientëve është e rrezikuar dhe punojnë për të përmirësuar politikat shëndetësore.

#### **Hulumtimi dhe Inovacioni**

Infermierët hulumtojnë kontribuojnë në praktikën e bazuar në dëshmi. Ata kryejnë studime, analizojnë të dhënat dhe zbatojnë gjetjet për të përmirësuar rezultatet e pacientëve.

Në përfundim, infermierët janë shpirti i kujdesit primar të shëndetit dhe ndikojnë thellë në mirëqenien e pacientëve dhe komuniteteve.

Numri i pacientëve në kujdesin primar është i lartë. Infermierët duhet të jenë të aftë të menaxhojnë një numër të madh të pacientëve dhe të ofrojnë kujdes cilësor për secilin prej tyre.

Infermierët janë të ngarkuar me detyra të shumta. Kujdesi ndaj pacientëve, dokumentimi, dhe koordinimi i kujdesit kërkojnë kohë të konsiderueshme.

#### **Kujdesi për pacientët me sëmundje kronike**

Shumica e pacientëve në kujdesin primar vuajnë nga sëmundje kronike, si diabeti, hipertensioni, dhe sëmundjet kardiovaskulare.

Infermierët duhet të kenë njohuri të thella për menaxhimin e këtyre sëmundjeve dhe të ofrojnë edukim për pacientët.

#### **Komunikimi Efektiv**

Infermierët duhet të jenë të aftë të komunikojnë me pacientët, familjet, dhe ekipin shëndetësor. Komunikimi i saktë dhe i kujdesshëm ndihmon në sigurinë dhe kujdesin e pacientëve.



INFERMIERIA - GJITHMONË NË SHËRBIM TË PACIENTIT



Donikë Novosella, BSc, Infermiere

## PËRJETIMET E NJË INFERMIEREJE

**S**i infermiere kam filluar punën profesionale pas përfundimit të shkollës së mesme “Ali Sokoli” Prishtinë nga viti 1994.

Nga pas lufta jam punësuar në kujdesin shëndetësor parësor në QMF -V Prishtinë nga korriku 1999. Në këtë Institucion Shtetëror kam qenë e sistemuar si infemiere e përgjithshme. Aty kam zhvilluar profesionin tim infermieror deri në vitin 2023.

Nga korriku 2023, jam emëruar infermiere përgjegjëse në QKMF Prishtinë ku ende është aktuale pozita ime.

### **Si u përjetua puna profesionale nga viti 1999!**

Ishte e si nuk ishte, përjetohej e si nuk përjetohej. Shumëçka ku ndiheshim më mirë se kurrë.

Fillimisht kemi punuar pa paga, dhe një kohë të shkurtër janë dhuruar ndihma humanitare si: batanije, hurma, furça për pastrimin e dhëmbëve etj.etj.

Një shembull i mirë që ne si profesionistë shëndetësorë kemi dëshmuar që dimë me qenë human, dimë dhe dëshirojmë të kontribuojmë profesionalisht.

Paga fillestare ishte 105 marka, pagë tepër modeste, që nuk mund të ia dilte dot asnjëri. Mirëpo dëshira dhe vullneti i mirë të punojmë në një vend të lirë kemi qenë të përbetuar që nëse është nevoja do të punojmë edhe pa paga si profesionist/humanist.



TË GATSHME NË ÇDO KOHË PËR TË MIREN E PACIENËVE TANË.

Të gjithë ishim të gatshëm për të arritur rezultatet më të mira të mundshme, për organizimin e punës, ofrimin e kujdesit shëndetësor, edukimin shëndetësor, planin emergjent eventual për pacientët të cilët ishin në situata të ndryshme pasi kishte pacientë të traumatizuar nga lufta e vitit 1999, të cilët kishin humbur anëtarë të familjes, disa me plagë nga lufta ku tek të cilët duhej kujdes më i veçantë.

Krejt në fund, uroj që angazhimi dhe kontributi ndaj profesionit ta ushtrojmë me besnikëri dhe të bëjmë më të mirën për të rritur nivelin profesional, për të miren e pacienëve tanë.



NJË SHEMBULL I MIRË QË NE SI PROFESIONISTE SHËNDETËSORE KEMI DËSHMUAR NË VAZHDIMËSI SE DIMË ME QENË SHUMË HUMANE...





Dr. Ramë Sadikaj, Specialist i internos

# SHËRBIMI SPECIALISTIK NË KUADËR TË QKMF NË PRISHTINË

Shërbimi Specialistik tani në QKMF i ka fillet e punës dhe formimit në fund të viteve 1970. Atëherë ky shërbim është themeluar në kuadër të ish Shtëpisë së Shëndetit në Prishtinë. Pas Luftës dhe Çlirimit të Kosovës nga okupatori pa humbur kohë është rifilluar me organizimin, riorganizimin e institucioneve shëndetësore në gjithë Kosovën. Njëjtë është vepruar edhe në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë (tani e tutje QKMF). Këtu do të shkruaj për Shërbimin specialistik nga: Mjekësia Interne, Reumatologjia, Oftalmologjia, ORL dhe Dermatologjia e të cilat me emër janë njohur si Shërbimi Specialistik Pranë QKMF Prishtinë. Radiologjia, Pediatria, Gjinekologjia dhe Biokimia kanë pasur struktura të veçanta organizative.

Puna ka qenë e organizuar sipas modelit të një ambulance specialistike. Sa i përketë aparaturës ka pasur vetëm EKG në çdo ambulancë, por pacientet kanë kryer me rekomandim të internistit edhe analiza laboratorike, RTG dhe EHO të abdomenit. Te gjitha këto shërbime kanë funksionuar në QKMF.

Ambulanca e Reumatologjisë përveç vizitave specialistike një kohë është kryer edhe egzaminimi i densitometrisë së kockave

Ambulanca e Syve kanë kryer vizita, heqje të trupave të huaj, egzaminimi i fundusit, vizusi, fusha visive, shpëlarja e kanalit të lotit,, heqja e qerpikëve, heqja e trupave të huaj etj.

Ambulanca e ORL: Janë kryer dhe kryhen: vizita specialistike nga lëmia e ORL, shpërlajre veshi, heqje e trupave të huaj të pakomplikuara, tamponade e perparme dhe e pasme të epistaxa etj.



### PUNA EKIPORE E ZGJIDHË ÇDO PROBLEM

Ambulanca e Dermatologjisë ka funksionuar në QKMF, si dhe në këto qendra: QMF III, QMF IV, QMF V dhe QMF VI. Po theksoi se unë dr. Ramë Sadikaj kam karrierën time profesionale të mjekut specialist e kam kaluar në kuader të Shërbimit Parësorë Shëndetësor të komunës së Prishtinës dhe atë prej 01.12.2002 në QMU, Prishtinë e deri më 30.11.2014. Spitali i qytetit ka qenë një synim që ka mbetur i parealizuar. Ideja bazë ka qenë që të gjithë specialistët e lëmvive përkatëse, përfshirë mjekësinë interne të cilën e kam përfaqësuar unë me vite, të kalojnë në shërbimet sekondare të këtij spitali, ashtu siç do të ishte dashur të jetë për mjekët specialist. Shpresoj se kjo do të realizohet në të ardhmen, edhe për faktin se shërbimet specialistike në Kujdesin Primar çdo ditë e më shumë po kalohen në duart e mjekut familjar.

Për shkak të ndërrimit të strukturës organizative në Kujdesin Parësorë Shëndetësorë në RKS dhe ndërrimit të infrastrukturës ligjore shërbimet specialistike pas pensionimit, shërbimet specialistike tjera vazhdojnë në nivelin e kujdesit sekondar apo terciar.



Gjylie Sherifi, BSc, Mrs, Infermiere

## PEDIATRIA NË KRYEQYTET - NJËSI E DASHURISË & PËRKUJDESJES SË FËMIJËVE

**D**ita e 21-të e muajit qershor, ditë e hënë, e vitit 1999 do të mbetet e gdhundur përherë në mendjen time , sepse pikërisht atëherë u hapën dyert e repartit të Pediatri në QKMF-Prishtinë, ku isha prezente edhe unë .

Ishin këto hapat e parë të lirisë, të themelimit të shtetit tonë. E gjithë popullata e vendit ndjehej e lirë dhe e sigurtë për t'ju drejtuar institucioneve shëndetësore të Kryeqytetit.

Dëshira nga mjekët dhe infermierët për t'ju shërbyer qytetarëve kishte kaluar çdo kufi , sepse t'i kontribosh shëndetit të fëmijëve ishte kënaqësi e veçantë .

Edhe pse kanë kaluar dekada që nga atëherë, fillimet e njesisë së Pediatriisë i kam aq të kthjelluara në kujtesë. Patjetër se në një kohë të tillë vështirësitë ishin të pashmangshme. Mungesa e rrymës elektrike, mungesa e materialit, terapia e pamjaftueshme ishin mjaft të theksuara , por me zgjatjen e dorës nga shoqatat humanitare, bamirëse mundësohej lehtësimi i punës. Pavarësisht pagave tejet të ulëta , vullneti për punë ishte shumë I madh si dhe çdo gjë bëhej e mundur për shkak të punës ekipore të personelit të Pediatriisë që të arrihej përkujdesja më e mirë e mundshme për pacientët .

Drejtuesit tanë që menaxhonin në mënyrë të shkëlqyeshme punën e zellshme në repart ishin gjithmonë të gatshëm për këshillimin dhe inkurajimin e mjekëve dhe Infermiereve të reja . Në repartin e Pediatriisë ofroheshin shërbime nga mosha 0-18 vjeçare .



KUJDESI PEDIATRIK ËSHTË PJESE VITALE E RITJES  
& ZHVILLIMIT NË FAZAT E HERSHME TË JETËS

Një ndër prioritetet tona thelbësore ishte informimi i qytetarëve rreth përkujdesjes shëndetësore të fëmijëve . Këshillimorja ishte një pjesë e rëndësishme e repartit , ku prindërit merrnin këshilla dhe informacione rreth rritjes së shëndetshme të fëmijës. Shpeshherë përgatisnim ligjerata nga më të ndryshmet dhe mbanim trajnime.

Një parim tjetër shumë i rëndësishëm i punës sonë ishte komunikimi dhe qasja sa më e ngrohtë me qytetarët, për të cilën ata ndaheshin tejet të lumtur. Me kalimin e viteve , njësia e Pediatriisë shëndrrohej në një institucion ku fëmijët vinin me vullnet .

Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Drejtoria e QKMF-së kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve dhe organizimin e përgjithshëm të punës. Ato qëndrojnë në themel të zhvillimit të shëndetësisë në Kryeqytet.

Renovimet e Institucionit , sot kanë krijuar një ambient shumë të këndshëm për fëmijë . Duke u nisur nga hapësirat e gjera dhe komode , muret e mbushura me plot ngjyra dhe figura atraktive , këndi i lojrave , programet edukative , njësia e Pediatriisë është shëndrruar në një mjedis të ngrohtë dhe të sigurtë për fëmijët .

Mjekët dhe infermierët respektojnë kodet etike profesionale si dhe i kushtohet rëndësi e veçantë qasjes, komunikimit si dhe trajtimit të pacientëve për çfarëdo shqetësimi që ata drejtohen tek ne .



#### VIZITAT E RREGULLTA TË FËMIJËVE TË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE JANË ME SHUMË INTERES

Gjithmonë të prirur nga ambicia për të ofruar shërbimin më të mirë të mundshëm, mbahen trajnime të vazhdueshme si për mjekë ashtu edhe për infermierë ku puna lehtësohet çdo herë e më shumë me metodat e reja që zhvillohen përmes këtyre trajnimeve. Me rrjedhjen e kohës , me zhvillimin e teknologjisë , me tejkalimin e sfidave plot vullnet , njësia e Pediatriisë është ajo që kemi sot.

Kujdesi pediatrik është pjesë vitale e rritjes dhe zhvillimit në fazat e hershme të jetës , prandaj në repartin tonë me dyer të hapura dhe mikpritëse i presim të gjithë prindërit që kanë nevojë për konsultime ,këshillime dhe trajtim të fëmijëve .

Kënaqësia më e madhe e punës fitohet pikërisht gjatë ndihmës fizike , psikologjike, emocionale, përkatësisht gjatë kujdesit që ofrojmë , sepse kujdesi për të tjerët është mënyra më e admirushme e të shprehurit dashuri .



Dr. Erzen Begolli, Specialist i gjinekologjisë dhe obstetrikës


# QENDRA PËR MIRËQENIEN E GRUAS DHE SHËRBIMET QË OFRON

Shërbimi Gjinekologjik që nga qershori i vitit 1999 ka funksionuar brenda atëherët të quajtur “Shtëpia e Shëndetit” (tani Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare) dhe ka punuar në dy ndërrime. Shërbimi ka ofruar vizita të përgjithshme gjinekologjike dhe obstetrike dhe në atë kohë qendra ka pasur vetëm një ultrazë të përdorur.

Në dhjetor të 2006 është bërë renovimi i shërbimit dhe në mars 2007 ky shërbimi është transformuar nga Shërbimi Gjinekologjik në Qendër për Mirëqenie të Gruas (QMG).

Shërbimi ka funksionuar në dy ndërrime dhe ka ofruar: vizita specialistike gjinekologjike-obstetrike, vizita dhe këshillime nga mjeku familjar, kolposkopi, aplikimi dhe heqja e IUD (spirales); kauterizimi i qafës së mitrës, CTG (cardiotocography), përpunim i plagës pas prerjes cezarijane (s.c.), testi i shtatzënisë, këshilla individuale dhe edukim shëndetësor në grupe me gra.

Më parë QMG ka ofruar edhe shërbime laboratorike, si: hemogram, sedimenti i eritrociteve, glikemia, strisho vagjinale dhe cervicale, testi rapid në Chlamydia, Trychomonas dhe Candida. Me riorganiziminin e punës disa nga këto teste ofrohen nga laboratoritë e QKMF-së, kurse strishoja vagjinale me testet përkatëse bëhen në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik.



## SHËRBIMET NË QMG OFROHEN PËR GRA & VAJZA

Prej vitit 2019 në QMG, QMF-V, QMF-VI ofrohet shërbimi i Pap testit. Deri më tani janë bërë gjithsejt: QMG – 9902 teste, QMF-V 2040 teste dhe QMF-VI 1830 teste. Pap testi bëhet me termin dhe ofrohet falas.

Shërbimet në QMG ofrohen për grate dhe vajzat e Kryeqytetit, por, me raste, edhe të komunave të tjera dhe këto bëhet me rekomandim të mjekut familjar.



Xhevahire Shala, Infermiere

# COPËZA TË KUJTIMIT TIM, MBI PËRKUSHTIMIN DHE SAKRIFICËN TIME NË OFRIMIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR

Infermiera, për mua, është më shumë se një profesion, është një udhëtim ku kam mësuar vazhdimisht për ngjarjet dhe mrekullitë që ndryshojnë jetën e të sëmurëve dhe të lëndurve me nevojë. Të prekësh jetën e të tjerëve ose të prekësh nga historia e tjetrit është një përvojë që nuk mund të përshkruhet.

Në vitin 1980, kam filluar karrierën time si infermiere në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Prishtinë, që kam treguar kujdes, ndihmë ndaj të sëmurëve në kryerjen aktiviteteve infermierore që do të kontribuojnë në ruajtjen shëndetin, dhe kujdesit ndaj të personave të pafuqishëm, të *pafat e* me nevojë, ku me njohuritë dhe aftësitë e mia infermierore kam



ofruar kujdes shëndetësor në vazhdimësi edhe në komunitete. Por në atë kohë të vështirë, ishte shumë e domosdoshme për zhvillimin e sistemit shëndetësor në Kosovë. Shumica nga ne ishim të përkushtuar për të ofruar kujdes shëndetësor, duke respektuar parimet morale dhe etike të profesionit mjekësor për të gjithë të sëmuret tanë.

Megjithatë, në vitin 1990, regjimi serb na largoi me dhunë nga vendet tona të punës. Kjo periudhë ishte një kohë e errët dhe e dhimbshme për të gjithë ne. Pavarësisht kësaj, unë dhe shumë kolegë të tjerë nuk u dorëzuam. Gjatë kohës sa ishim të larguar nga puna, ne kontribuam në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për popullatën, duke u përpjekur të zbusnim vuajtjet dhe mungesën e kujdesit shëndetësor që kishin qytetarët tanë.

Ky përkushtim dhe solidaritet na ndihmuan të qëndrojmë të fortë dhe të bashkuar në kohët më të vështira.

Rikthimi në punë ishte një moment me shumë emocione të forta, gëzim për lirinë e fituar, por edhe një ndjenjë e thellë e përgjegjësisë për rindërtimin e sistemit të kujdesit shëndetësor me të gjitha strukturat përcjellëse për avansimin dhe fuqizimin e sistemit shëndetësor në Prishtinë.



RIKUJTIM / VITET 1999 & 2024


Edhe pse në fillim ishte sfidë jo aq e lehtë, por ne përballëshim me mungesë të barnave, pajisjeve mjekësore dhe materialit shpenzues. Por ne ishim të detyruar dhe shpeshherë të punojmë edhe në kushte të vështira të punës, objektivi dhe qëllimi ynë ishte në ofrimin e kujdesit shëndetësor me cilësi më të lartë për qytetarët tanë. Solidariteti dhe bashkëpunimi mes nesh ishin forcë shtytëse në këtë proces.

Në këtë 25 vjetor të çlirimit të Kosovës, shikoj prapa me krenari dhe mirënjohje për të gjithë ata që kanë kontribuar dhe kanë qëndruar të palëkundur në këtë rrugë. Kontributi ynë i përbashkët ka qenë themel për rindërtimin e Kosovës dhe për krijimin e një sistemi të mirëfillët shëndetësor që sot t'u shërbehet me dinjitet dhe me profesionalizëm të gjithë qytetarëve.

Historia jonë është dëshmi e qëndrësës dhe përkushtimit të palëkundur përballë sfidave dhe vështirësive. Ajo na kujton se, edhe në kohët më të errëta, humanizmi dhe solidariteti mbizotërojnë, duke na udhëhequr drejt një të ardhme më të ndritur dhe më të sigurtë për të gjithë.

Ky përvjetor na bën të reflektojmë mbi sakrificat dhe arritjet tona, duke na frymëzuar për të vazhduar punën me të njëjtin përkushtim, këndvështrim pozitiv, motiv, reflektim në ofrimin e kujdesit shëndetësor për t'u ofruar shpresë të sëmureve në përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor.

**"Shpesh është thënë se, çdo grua mund të jetë një infermiere e mirë".**



Bukurije Bunjaku, Infermiere

# ROLI I DSM NË MENAXHIMIN E TB NË KRYEQYTET

**D**ispanseri i Sëmundjeve të Mushkërive (DSM) është themeluar në vitet e 50-ta dhe ka pasur për qëllim luftën kundër tuberkulozit (TB). DSM ka rol në zbulimin, trajtimin dhe eliminimin e TB-se. Në kuadër të DSM ka funksionuar shërbimi i patronazhës, i cili ka qenë i angazhuar me vizitat shtëpiake të të sëmurëve dhe anëtarëve të familjes të tyre. Gjithashtu ka funksionuar edhe shërbimi i vaksinimit, i cili veprimtarinë e tij e ka shtrirë në Prishtinë dhe gjithë fshatrat për rreth saj. Përveç kësaj, janë hulumtuar rastet e kontaktit dhe dhe mbrojtja e tyre. Gjithashtu ka ekzistuar edhe shërbimi i vizitave sistematike, i cili veprimin e tij e ka shtrirë në grupet specifike si: studentët, nxënësit si dhe grupet tjera të rrezikuara.

Qëllimi kryesor i kontrollit të TB-së është për të zvogëluar sëmundjen e TB-së dhe ndikimin e saj në shëndetin e popullatës, si dhe zhvillimin e përgjithshëm social dhe ekonomik në vend, duke siguruar qasje universale në diagnostikimin, kujdesin, trajtimin në kohë dhe cilësor për të gjitha format e TB-së.

Kujdesi Parësor Shëndetësor përherë e më shumë po e merr përsipër menaxhimin e TB përmes Njësive të Sëmundjeve të Mushkërive dhe TB (ish DAT) dhe Mini Laboratorëve për BK dhe Xpert në DAT Prishtinë.

Cili është roli i DSM sot?

- Bën diagnostikimin e patologjisë respiratore;
- Bën përpilimin e protokoleve terapeutike në patologjinë respiratore;
- Përcakton nevojën e ekzaminimeve laboratorike, radiologjike etj. në shërbim të diagnostikimit të sëmundjeve respiratore;
- Jep mendimin profesional në kërkesa zyrtare, merr pjesë në vlerësimin e aftësisë së punës.

Menaxhimi i TB-së në KSHP për të rritur kapacitetet profesionale të mjekëve familjare për të ofruar këto shërbime

Shërbimet të cilat ofrohen janë: baciloskopia direkte, testi GenXpert, PPD (perpunim i kontaktit), spirometria, rëntgeni i mushkërive, testet laboratorike. Jepen barnat falas për pacientët, bashkë me to jepet edhe pako ushqimore dhe higjienike. Bëhet edukim dhe promovim shëndetësor i pacientëve, shpërndarja e borshurave, hapësirat janë të mëdha, të ventiluara mire dhe me pajisje modern që l shkatërrojnë mikrobet siç janë rrezet ultravioleta.

Në saje të punës së DSM niveli i të diagnostikuarve dhe të trajtuarve me TB viteve të fundit është përgjysmuar krahasur me vitet e 50-ta. Kohëve të fundit me zhvillimin e mjekësisë familjare shumë nga kompetencat e DSM po kalojnë në Kujdesin Parësor Shëndetësor.



OBJEKTI & STAFI SHËNDETËSOR I NJËSISË SË TB



Fikrie Ademi, BSc, Infirmiere

# ROLI DHE RENDESIA E INFERMIERISE KRYEQYTETASE

**U**në si infermiere me përvojën time mbi 30 vjeçare tërë aktivitetin time ia kam kushtuar profesionit në shërbim të qytetarëve.

Qendra e Mjekësisë Urgjente e periudhës së pasluftës është ballafaquar me shumë vështirësi. Gjatë kësaj kohë punëtorët shëndetësorë punonin në kushte jo shumë të mira: mungonin barërat, nuk kishte uniforma të përshtatshme, kishte fluks të madh të pacientëve dhe shpesh mungesë të rrymës elektrike.



## TRAJNIMET E INFERMIEREVE, PJSË E EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL

Rëndësia dhe roli i infermierit u avansua me krijimin e Asociacionit të Infermierëve të Kosovës, e cila u munësoi infermierëve t'i adresojnë kërkesat dhe nevojat e tyre. Pjesë e këtyre iniciativave kam qenë edhe vetë. Fokusi ka qenë përmirësimi i shërbimeve shëndetësore për popullatën e Kryeqytetit, por edhe për të tjerët që kanë kërkuar ndihmë mjekësore.

Avansimi i mëtejshëm i infermierisë ka vazhduar gjatë viteve 2001-2003 me Trajnimin e Trajnerëve për infermieri familjare në Kujdesin Parësor Shëndetësor. Janë trajnuar mbi 300 infermierë në 18 grupe të ndryshme. Krahas edukimit bazik të infermierëve është realizuar edhe programi për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional, i cili ka kontribuar në rilicencimin të infermierëve, si dhe kuadrit të mesëm të profileve të ndryshme: mami, asistent i stomatologjisë, laborant dhe teknik i radiologjisë.

Pandemia COVID-19 ka qenë sfidë e radhës për infermierinë në Kryeqytetit pasi që është kërkuar të bëhen një riorganizim tjetër për të përballuar këtë situatë.



PUNA E PALODHUR NË  
PANDEMINË COVID-19 ISHTE  
DËSHMI E ANGAZHIMEVE TË  
PASHOQA NGA INFERMIERET

Roli që iu dha infermierisë në këtë kohë pandemia, infermierët e Kryeqytetit bashkë me mjekët e kanë përmbushur me sukses dhe në mënyrën më të mirë profesionale. Krahas gjërave të tjera është realizuar edhe vaksinimi i qytetarëve.

Me kalimin e viteve janë bërë investime të mëdha gjë që ka ndikuar që qendrat e mjekësisë familjare të Kryeqytetit të përmirësohet në pikëpamje infrastrukturore, rritje të stafit dhe të shërbimeve mjekësore, pajisjes me mjete dhe me medikamente, që ka mundësuar që roli i infermierit të jetë një shembull i mirë se si ofrohen shërbime cilësore për qytetarët.



OFRIMI I SHËRBIME CILËSORE PËR QYTETARËT ËSHTË SATISFAKSION I MADH



Prof. Ass. Dr. Valdet Hashani, MD, MSc, PhD, Specialist i mjekësisë familjare.

## Disa informacione për mjekësinë familjare

Politika e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) në mbarë botën përqendrohet në sigurimin universal të shërbimeve të mbrojtjes parësore shëndetësore, të cilat ofrojnë shërbime shëndetësore të kualitetit të lartë, lehtë të çasëshme, jo të shtrenjta (të përballueshme) dhe të cilat janë në dispozicion 24 orë, e që është shumë e rëndësishme për “rolin e ruajtjes së portës” së shërbimeve shëndetësore të një vendi.

Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH) prezanton fusha të rëndësishme të shërbimeve shëndetësore si, “ruajtësi i portës”, regjistrimi fillestar i pacientëve, kontrollimi dhe distribuimi i mjekëve, zvogelimi i udhëzimeve (referimeve) apo vetëreferimet në sistemet tjera shëndetësore si dhe shërbimi 24 orësh për popullatën.

Një rrjetë e shërbimeve shëndetësore në kujdesin parësor shëndetësor, përfshinë këto shërbime:

1. Parandalimi i sëmundjeve; 2. Trajtimi i sëmundjeve akute dhe kronike; 3. Rehabilitimi; 4. Menaxhimi i sëmundjeve që zgjasin shumë; & 5. Menaxhimi i kujdesit paliativ.

## Disa informacione për Mjekësinë Familjare

1. Organizata Botërore e Mjekëve Familjarë quhet WONCA.
2. Një raport i publikuar nga The Health Foundation vitin e kaluar zbuloi se mjekët e përgjithshëm australianë janë ndër më të lumturit në botë.
3. Luksemburgu si një vend të vogël evropian, i paguan më së miri mjekët familjar, mjekët familjar fitojnë rreth 235.000 € në vit. Irlanda 172,882 €, Holanda 160,869 €, Danimarka 156,061 € dhe Islanda 155,276 €, pastaj pasonë Gjermania me 146,200 € dhe Britania e Madhe 136,375 €/vit. Në Kosovë paga vjetore e mjekut familjar neto është 13809.6 euro. Kjo rrogë është përafërsisht e njëjtë edhe në vendet e rajonit si dhe në Shqipëri.
4. Ndër vendet anëtare të BE-së, Austria ka 540 mjekë familjar për 100,000 banor, që i bie 1 mjek familjar në 185 banorë, përderisa te ne me ligj është e përcaktuar 1 mjek familjar në 2000-2500 banorë.
5. Në vitin 1966 u organizuar dy programet e para të specializimit në mjekësinë familjare, në Universitetin e Calgary dhe në Universitetin e Ontarios Perëndimore (tani Universiteti Perëndimor). Programet ishin trevjeçare dhe të diplomuarit u kualifikuan për t'iu nënshtruar provimit të parë të Çertifikimit në Mjekësi Familjare në vitin 1969.



**Kujdesi Parësor Shëndetësor-KPSh**  
*përfshinë*

1. Parandalimin e sëmundjeve,
2. Trajtimin e sëmundjeve akute dhe kronike,
3. Rehabilitimin,
4. Ndihmën shtëpiake për të paafte ose për personat fizikisht të dobët,
5. Menaxhimin e sëmundjeve që zgjasin shumë,
6. Menaxhimin e kujdesit paliativ.

6. Në Kanada dhe Britani mjekësia familjare-GP u krijua në vitet 1960.
7. Në Izrael programet e para zyrtare të trajnimit për specializim në mjekësi familjare u iniciuan në vitin 1977 dhe sot ka 11 departamente në të gjithë vendin, secili ka lidhje akademike me një nga katër universitetet-fakultete të mjekësisë, duke ofruar programe specializimi në Mjekësi Familjare (Universiteti Ben-Gurion, Universiteti Tel-Aviv dhe Technion). Izraeli ka një sistem shumë të mirë-zhvilluar të kujdesit parësor me klinika të vendosura në komunitet, në të gjithë vendin (urbane, periferike dhe rurale). Rreth 97 për qind e popullsisë ka mbulim mjekësor përmes Sigurimit Kombëtar Shëndetësor.
8. Specializimi në Mjekësi Familjare në shumicën e vendeve të botës (përfshi edhe Kosovën) zgjatë 3 vjet. Disa vende e kanë zgjatur në 4 vjet, me mundësi trajnimi shtesë në fusha të veçanta.
9. Programi i Specializimit të Mjekësisë Familjare në Kosovë ka filluar në vitin 2000.
10. Sot Programi Specialistik i Mjekësisë Familjare në Kosovë është Program tre vjeçar specialistik dhe është i pranuar Ndërkombtarisht nga Kolegji Mbretëror i Mjekëve Familjar Mbretëria e Bashkuar – Royal College of General Practitioners / UK (RCGP)



11. ASOCIACIONI I MJEKËVE FAMILJAR TË KOSOVËS – AMFK/AFPK ËSHTË ANËTAR ME TË DREJTA TË PLOTA NË ORGANIZATËN BOTËRORE TË MJEKËVE FAMILJAR  Wonca World.

12. Shumë anëtarë tanë të AMFK-së janë anëtarë të Akademisë Amerikane të Mjekëve Familjar - AMERICAN ACADEMY OF FAMILY PHYSICIANS / AAFP, e janë edhe anëtar ndërkombëtar të Kolegjit Mbretëror të Mjekëve Familjar / Mbretëria e Bashkuar – Royal College of General Practitioners / UK (RCGP-UK).



13. Në ShBA në vitin 2021 janë të regjistruar 268.297 Mjekë në KPSH,

14. Në Mbretërinë e Bashkuar / UK (2024) numri i GP (Mjekëve Familjarë-MF) është 54,624,

15. Gjermania ka 377 000 MF,

16. Italia ka 243 000 MF,

17. Franca ka 216 000 MF,

18. Spanja ka 213 000 MF,

19. Austria ka 48 000 MF,

20. Shqipëria ka 1600 MF,

21. Kosova ka 800 MF.

### Literatura

1. <https://www.globalfamilydoctor.com/home.aspx>
2. <https://www.globalfamilydoctor.com/members/ForMemberOrganizations/WorldFamilyDoctorDay.aspx>
3. <https://smartmedicalbuyer.com/blogs/smb-blog/world-family-doctors-day-history-and-significance>
4. <https://www.cfpc.ca/en/family-doctor-day>
5. <https://www.globalfamilydoctor.com/news/special-feature/WorldFamilyDoctorDay.aspx>
6. <https://nationaltoday.com/world-family-doctor-day/>
7. <https://www.chicago.org/wins-article/may-19-is-world-family-doctor-day/>
8. <https://www.rcgp.org.uk/>
9. <https://www.aafp.org/home.html>
10. <https://www.breitbart.com/australia/news/australian-gps-amidst-happiest-week/>
11. <https://www.euronews.com/health/2023/03/17/doctors-in-the-eu-which-countries-have-the-most-physicians-and-healthcare-workers>
12. <https://www.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC5471080/>
13. <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC5471080/>
14. <https://www.medrxiv.org/content/10.1101/2023.03.17.23281111v1>

Designed by: Dr. Val D. '24



ASOCIACIONI I  
MJEKËVE  
FAMILJARË TË  
KOSOVËS



ASSOCIATION OF  
FAMILY  
PHYSICIANS OF  
KOSOVA



Wonca

Member of

Global Family Doctor





## Betimi i Hipokratit

*Në çastin kur po hy në radhët e anëtarëve të profesionit mjekësorë solemnisht betohem se jetën time do ta vë në shërbim të humanitetit.*

*Ndaj mësuesve të mi do ta ruaj mirënjohjen dhe respektin e duhur. Profesionin tim do ta ushtroj me ndërgjegje e me dinjitet. Shëndeti i pacientit tim do të jetë brenga ime më e madhe. Do ti respektoj e do ti ruaj fshehtësitë e atij që do të më rrëfëhet. Do ti ruaj me të gjitha forcat e mia nderin e traditën fisnike të profesionit të mjekësisë. Kolegët e mi do ti konsideroj si vëllezërit e mi. Në ushtrimin e profesionit ndaj të sëmurit, tek unë nuk do të ndikoj përkatësia e besimit, kombit, racës, politikës apo përkatësia klasore. Zë nga fillimi do ta ruaj jetën e njeriut në mënyrë absolute. As nën kërcënim nuk do të lejoj të keqpërdoren njohuritë e mia mjekësore që do të ishin në kundërshtim me ligjet e humanitetit. Këtë premtim po e jap në mënyrë solemne e të lirë, duke u mbështetur në nderin tim personal.*

*Hipokrati*  
460-377



## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI

### QKMF - QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

#### QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Rr. "Fehmi Agani" Nr. 20,  
Nr. tel. 0800 38-012  
Nr. tel. 038 234-841

#### Orari i punës:

##### 24h

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 19:00

#### Ndërrimi i natës, kati përdheshë

Orari: 19:00 - 07:00

#### QMF I

Rr. "Ilir Konushevc" Nr. 24  
Nr. tel. 0800 38-001  
Nr. tel. 038 234-722

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF II

Rr. "Vëllezërit Fazliu"  
833 - Kodra e Trimave  
Nr. tel. 0800 38-002  
Nr. tel. 038 251-180

#### Orari i punës:

E hënë – e premte  
07:00 – 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF III

Rr. "Xheladin Kurbaliju"  
Nr. 20 - Taslixhe  
Nr. tel. 0800 38-003  
Nr. tel. 038 517-434

#### Orari i punës:

E hënë – e premte  
07:00 – 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF IV

Rr. "Myrvete Maksutaj"  
Nr. 15 - Medrese  
Nr. tel. 0800 38-004  
Nr. tel. 038 233-715

#### Orari i punës:

##### 24h

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 19:00

#### Ndërrimi i natës, kati përdheshë

Orari: 19:00 - 07:00  
E shtunë 07:00 – 19:00

#### QMF V

Rr. "Bulevardi i  
Dëshmorëve" Nr. 19 -  
Dardania  
Nr. tel. 0800 38-005  
Nr. tel. 038 522-735

#### Orari i punës:

##### 24h

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 19:00

#### Ndërrimi i natës, kati përdheshë

Orari: 19:00 - 07:00

#### QMF VI

Rr. "Hyzri Tailla" Nr. 89-  
Kodra e Diellit  
Nr. tel. 0800 38-006  
Nr. tel. 038 553-844

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF VII

Rr. "Agim Qela", lagjja  
"Kalabria"  
Nr. tel. 0800 38-007  
Nr. tel. 038 551-378

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF VIII

Rr. "Metush Krasniqi"  
Nr. 56, Arbëri  
Nr. tel. 0800 38-008  
Nr. tel. 038 604-210

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF IX

Rr. "Xhavit Ahmeti" Nr.  
229, lagjja "Vneshta"  
Nr. tel. 0800 38-009  
Nr. tel. 038 255-300

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF X,

Rr. "1 Tetori" - Velani  
Nr. tel. 0800 38-010  
Nr. tel. 038 516-036

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 15:00

#### QMF XI

Rr. "Abdyl Frashëri" Nr.  
10 - Lagjja e  
Muhaxhereve  
Nr. tel. 0800 38-011  
Nr. tel. 038 222-375

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF – Lagjja "Mati"

Rr. "Struga" Nr. 109 -  
Matiqan  
Nr. tel. 0800 38-015  
Nr. tel. 038 258-100

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF – Mati 1,

Rr. "Nezir Mujaj" Pa  
numer - Lagjja e Spitalit  
Nr. tel. 0800 38-016

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF – Hajvalia,

Rr. "Brigada" Nr.153 -  
Hajvali  
Nr. tel. 0800 38-013  
Nr. tel. 038 564-394

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF – Bardhosh,

Rr. "Skenderbeu" -  
Bardhosh  
Nr. tel. 0800 38-018  
Nr. cel. 048/977-168

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 20:00

#### QMF – Besia,

Rr. "2 Prill" - Besi  
Nr. tel. 0800 38-014  
Nr. tel. 038 515-994

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 15:00  
E shtunë 07:00 – 19:00  
E diele 07:00 – 13:00

#### QMF – Veternik,

Rr. "2 Prill" - Besi  
Nr. tel. 0800 38-01  
Nr. tel. 038 515-994

#### Orari i punës:

E hënë - e premte 07:00  
– 15:00

#### Shërbimi Shtëpiak

Rr. "Avdyt Frashëri"  
0800/99999  
038 551-559

#### QKMF-Vaksinimi

038/224-560


19 Maj

# DITA BOTËRORE E MJEKUT FAMILJAR PLANETI I SHËNDETËSHËM, POPULLI I SHËNDETËSHËM

ASOCIACIONI I  
MJEKËVE  
FAMILJARË TË  
KOSOVËS



ASSOCIATION OF  
FAMILY  
PHYSICIANS OF  
KOSOVA  
*member of*



19 May 2024



## WORLD FAMILY DOCTOR DAY.

HEALTHY  
PLANET,  
HEALTHY  
PEOPLE.



## 29<sup>TH</sup> WONCA EUROPE CONFERENCE

The Convention Centre Dublin  
25-28 September 2024

KONFERENCA E 29-TË  
WONCA EUROPË

25-28 Shtator 2024.  
Dublin, IRLANDË.

The Changing Nature of Family Medicine – Cultivating the Future



[www.woncaeurope2024.org](http://www.woncaeurope2024.org) | #woncaeurope2024

KONFERENCA E 25-TË  
WONCA BOTËRORE

17-21 Shtator 2025  
Lisbonë, PORTUGALI

„New vision for primary health  
care and sustainable development“



WONCA 2025  
25<sup>TH</sup> WONCA WORLD CONFERENCE  
17 - 21 SEPTEMBER 2025  
LISBOA CONGRESS CENTRE - CCL



#woncaworld2025

[www.woncaworld2025.org](http://www.woncaworld2025.org)